



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:276565
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730924

K.DH.SH.II.nr.1533/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit D.P.Z “Lola” ShPK me numër të biznesit 80207441 me seli në Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson pronarja S.I., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Inspektoratit të Punës me seli në Mitrovicë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.287/22, të datës 16.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit D.P.Z “Lola” ShPK me seli në Vushtrri, e datës 18.10.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.287/22, të datës 16.09.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Komeriale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadia e paditësit D.P.Z “Lola” ShPK me numër të biznesit 80207441 me seli në Vushtrri, e përfaqësuar nga pronarja S.I., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Inspektoratit të Punës me seli në Mitrovicë, me propozim që gjykata ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, të anuloj vendimin nr.258/2019 të datës 30.04.2019, të detyrohet e paditura ti paguaj shpenzimet procedurale, si e pa bazuar. Ndërsa, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja ka paraqitur ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim me të cilin aprovohet ankesa e paditëses DPZ Lola me nr. NUI 80207441 me seli në Vushtrri, ushtruar kundër aktgjykimit nr. KA 287/22 të datës 16.09.2023 i nxjerr nga Gjykata Komeriale në Prishtinë, Dhoma e Shkallës së Parë si i pa bazuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komeriale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e pa-bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e MPMS-IP, në Mitrovicë, nr.258/2019, të datës 30.04.2019, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë DPZ “Lola” me NRB 80207441, me seli në Vushtrri, e përfaqësuar nga S.I., dhe vërtetohet vendimi i Organit të Shkallës së Parë të Inspektoratit të Punës 02 nr.17/10 A, i datës 01.02.2019.

Kundër vendimit përfundimtar të organit administrativ paditësi me padi inicicion konflikt administrativ në procedurë gjyqësore, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 06.09.2023, dhe administrimit të provave të theksuara si në aktgjykimin e saj, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, duke iu referuar dispozitave ligjore sipas Ligjit të Punës, ka gjetur se padia e

paditësit është e pa bazuar, në arsyetim ndër tjera ka theksuar se pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësja, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Gjykata konstatoi se sipas Raportit zyrtar i IP-së, i përpiluar me datë 23.01.2019 me numër 02 nr.17109/2019 me të cilin është konstatuar gjendja faktike dhe paditësi është obliguar të sjell dokumentacionin që është kërkuar gjatë inspektimit: kontratat e punës për të punësuarat Kadrie Tërllabuqi dhe praktikanten Sebahate Pllana, dokumentacionin e ATK-së, dëshmitë e pagave, dëshminë e pajisjes së lokalit me aparat kundër zjarrit me kuti të ndihmës së parë deri më datë 28.01.2019. paditësja brenda afatit ligjor të përcaktuar nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e konstatuar në raport të inspektimit të punës. Në seancë të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datë 28.01.2019 të gjitha dokumentet i ka siguruar sipas urdhëresës së IP-së me datë 28.01.2019, po atë ditë nuk e ka gjetur vendin-zyrën e inspektoratit dhe është kthyer pa i dorëzuar dokumentet, ndërsa në ankesë kundër vendimit me nr. 02 nr. 17/10A të datës 01.02.2019 të parashtruar nga ankuesja ka deklaruar se dokumentacionin e kërkuar e ka kompletuar dhe ka shkuar tek Inspektorati i Punës në Mitrovicë, me datë 28.01.2019 në ora 09:00, mirëpo punëtorët e inspektoratit të Punës nuk kanë qenë në vendin e punës edhe pse e kanë ditur se po në këtë datë e kanë urdhëruar parashtruesin e ankesës që të sjell dokumentacionin e kërkuar, duke theksuar se nuk ka vepruar sipas dokumentacionit të kërkuar. Gjykata vlerësoi se pretendimet e paditëses nuk kanë mbështetje me provat e administruara dhe me dispozitat ligjore materiale të cituara më lartë, për të vërtetuar një gjendje të ndryshme faktike dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar është në përputhje me nenin 46 dhe 47 të LPPA-së. Andaj gjykata bazuar në nenin 13 par.1, nën par 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se me rastin e refuzimit të kërkesë padisë së paditësit në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale dhe drejtë është vlerësuar ligjshmëria e vendimit të organit të paditur si në vështrim të nenit 43 dhe 44 të LKA-së, sepse organi administrativ i shkallës së parë i-TEIP, ka konstatuar se tek paditësja gjatë inspektimit është hasur në një punëtorë dhe një praktikantë për të cilat paditësja për to kanë qenë e obliguar që të lidh kontrata pune ashtu siç parashihet në nenin 10 të Ligjit të Punës dhe ti lajmëroj në ATK, të prezantoj dëshmi se të njëjtat marrin pagë,

obligim ky i paraparë në nenin 7 pika 4 dhe nenin 55 të Ligjit të Punës dhe njëherit që këto dëshmi paditësja ti paraqes Inspektoratit të punës brenda afatit ligjor. Po ashtu paditësja ishte obliguar që në bazë të nenit 11.1, 13.1.10 si dhe nenit 22.2 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-161, të pajisë lokalin me aparate kundër zjarrit dhe kuti të ndihmës së parë, mirëpo që e njëjta nuk ka ofruar dëshmi dhe prova për të dëshmuar të kundërtën duke mos iu përgjigjur në afatin ligjor të paraparë nga e paditura, andaj inspektorati i punës duke vepruar në kuadër të kompetencave për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë, me të drejtë ka zbatuar dispozitën e Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr.2002/9 nga neni 5 paragrafi 5.5 shkronja b), duke i dhënë punëdhënësës afat për prezantimin e dokumentacionit të kërkuar, ndërsa e njëjta nuk i është përgjigjur afatit të përcaktuar për eliminimin e parregullsive. Andaj, e paditura IP me vendimin 02 nr.17/10 A, i datës 01.02.2019 i ka shqiptuar gjobë paditëses në shumë prej 800.00€ për respektim të nenit 10, 7 dhe nenit 55 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, vendim ky më pas i vërtetuar me vendimin nr.258/2019, të datës 30.04.2019 të kontestuar nga ana e paditëses.

Pretendimet ankimore të paditësit, kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe vlerëson se janë të pa bazuara në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike të çështjes në shqyrtim, dhe jo me ndikim për vendosjen ndryshe sepse aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të LKA, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë si në vendimet e organi të paditur të konfirmuara si ligjore dhe në procedurë gjyqësore, sepse paditësi nuk ka lajmëruar në ATK punëtorët të njëjtat nuk marrin pagë, paditësja po ashtu nuk ka bërë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, nuk ka plotësuar kushtet për siguri në punë duke mos pajisur lokalin me aparate kundër zjarrit dhe kuti të ndihmës së parë. Ndërsa, sa i përket pretendimit në ankesë se gjykata ka anashkaluar dokumentet dhe ka vërtetuar një aktvendim të pa bazë të ushtruar dhe të përpiluar si dhe të gjobitur pa bazë duke mos argumentuar dokumentet e besueshme të përgatitura dhe të dërguara me kohë dhe vend të caktuar e që në mungesë të stafit të paditurës dhe derës së mbyllur të zyrave të IP në Mitrovicë, nuk janë dorëzuar dhe të njëjtët kanë paraqitur efekt negativ dhe kanë ndëshkuar për mospërfillje të kërkesave të inspektorëve të punës, përkundër situatës reale dhe faktike te paditëses si pronare e cila ka përjetuar sëmundjen e prindërve po në kohën e kontrollit, kolegji këto pretendime nuk i aprovoi pasi që vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga e paditura por edhe në procedurë gjyqësore nga Dhoma e Shkallës së Parë drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk

ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në këtë çështje juridike administrative, nga organi administrativ përfundimtar, MPMS-Inspektorati i Punës, dhe Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila rezulton se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuses, aktgjykimi i ankimuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i miraton edhe kolegji duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë, andaj i njëjti vërtetohet në tërësi si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1533/23, me datë 24.05.2024

Kryetare kolegjit,

Saranda Bogaj Sheremeti